

JANI THOMAJ

MBI MËNYRËN E PASQYRIMIT TË SISTEMIT TË KUPTIMEVE DHE PËRDORIMEVE TË FJALËVE NË FJALORIN SHPJEGUES TË GJUHËS SHQIPE

Diskutimi i problemeve të ndryshme leksikologjike e leksikografike lidhur me "Fjalorin e gjuhës shqipe" të Institutit të Shkencave (1954), në dritën e përpunimit të parimeve për hartimin e një fjalori normativ të gjuhës shqipe, — diskutim që nis me studimin e gjerë të A. Kostallarit¹⁾ dhe vazhdon me artikujt e Dr. Prof. A. Xhuvanit²⁾, O. Myderrizit³⁾, F. Ndocajt⁴⁾ dhe P. Gecit⁵⁾, — nxjerr në shesh se ky fjalor, i vetmi i llojit të tij gjer tani, padyshim i tejkalon shumë fjalorët e mëparshëm në shumë drejtime⁶⁾. Krahas kësaj del në shesh gjithashtu se me këtë fjalor nuk janë zgjidhur, e as që mund të zgjidheshin, shumë probleme teorike të leksikologjisë e leksikografisë shqipe. Sadoqë të kemi tradita në lëmin e hartimit të fjalorëve kjo është e pamjaftueshme dhe e verbër pa teorinë leksikologjike e leksikografike, pa shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë problemeve në një plan teorik përgjithësues.

Sot kur është grumbulluar një material mjaft i pasur leksiko-frazeologjik nga gjuha e popullit dhe nga të gjitha stilet e gjuhës së shkruar, për fjalorin e gjuhës shqipe shtrohet edhe kërkesa që të hartohet sipas parimesh të përcaktuara shkencërisht, në përputhje me nivelin e sotëm të teorisë leksikologjike e leksikografike. Rrahja e këtyre parimeve themelore në terrenin e shqipes, duke mbajtur gjithënjë parasysh realizimet themelore më të fundit të teorisë leksikologjike e leksikografike, mbetet një nevojë e përherëshme, e veçanërisht me rëndësi të madhe në prag të hartimit të një fjalori të ri të shqipes.

Kjo kumtesë është një vazhdim i diskutimit rreth disa problemeve të parrahura, por të rëndësishme, lidhur me "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) dhe me detyrat e fjalorit të ardhshëm. Ndër këto probleme na tërheq vëmendjen *struktura kuptimore* e fjalëve, dmth. vargu i *kuptimeve* leksikore të formuara nga pikëpamja linguistike, çështja e *kuptimeve* jo të lira, *frazelogjikisht të lidhura* të fjalëve, çështja e *përdorimeve* të figurshme të fjalëve, kalimi i këtyre në elemente gjuhësore, si dhe çështja e *pasqyrimit në fjalor* të kuptimeve leksikore, frazeologjike dhe të përdorimeve të fjalëve.

Kuptohet që edhe ky artikull nuk i zgjidh, e as që mund t'i zgjidhë, për-

- 1) A. Kostallari: "Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme", në "Bul. Shk. Shoq.", 1955, IV, 47-57.
- 2) Prof. A. Xhuvani: "Çështja e Fjalorit të gjuhës shqipe", në "Nëndori" 1957, 151-163.
- 3) O. Myderrizi: "Rreth ripunimit të "Fjalorit të gjuhës shqipe", në "Bul. Shk. Shoq.", 1957, II, 204-221.
- 4) F. Ndocaj: "Veçantia e gjuhës dhe Fjalori i Institutit të Shkencave", në "Bul. Shk. Shoq.", 1958, II, 159-195, etj.
- 5) P. Geci: "Pasunia e leksikut të shqipes dhe Fjalori i gjuhës shqipe; në "Bul. Shk. Shoq.", 1959, I, 157-162.
- 6) Shih A. Kostallari, *art, i cit.*, f. 17-18.

fundimisht problemet që shtrohen këtu për diskutim. Ky brumë duhet ngjeshur e rrahur shumë gjer sa të shtrohet për bukë. Megjithatë besojmë se do të jetë arritur qëllimi, po qe se me këtë artikull ishtohet një rrëke lumit të përpjekjeve për përpunimin e parimeve themelore, mbi bazën e të cilave do të hartohet fjalori i ardhshëm i shqipes.

Në "Shënime mbi përdorimin e fjalorit" thuhet se "Shprehjet frazeologjike (nënvizimi është yni — J. Th.) janë shpërndarë brenda paragrafit duke u vënë pas kuptimeve, me të cilat lidhen. Vijnë në fund, zakonisht pas një vize vertikale / (kupto: "pas një vize të pjerrët" — J. Th.) kur kuptimi i përgjithshëm i tyre s'lidhet drejt për drejt me kuptimet e fjalës që shpjegohet.

Janë shoqëruar me shënimin *fig.* kuptimet e figurësime të fjalëve" ¹⁾ Siç shihet edhe konkretisht pastaj brenda në "Fjalor . ." termi "shprehje frazeologjike" është përdorur këtu nga autorët e "Fjalorit . ." me një kuptim shumë të gjerë. I tillë konsiderohet çdo kontekst, çdo frazë, çdo togfjalësh, bile shpesh herë edhe fjalë me një lidhje të çfarëdoshme në ligjëratë, por me kuptim të figurshëm. Ky koncept, i cili nuk përputhet me atë që pranon, me sa dimë, shkencën e sotme leksikologjike-leksikografike, mbizotëron edhe në fjalorë të tjerë të shqipes, si dhe në disa gramatika. Mendojmë se kjo është një çështje parimore teorike dhe jo thjesht një çështje termi. Ky të kuptuar i kategorisë së shprehjeve frazeologjike na duket gjithashtu se është pikënisja, prej nga marrin fill dy gabime që vihen re në gjithë fjalorët e shqipes. Po i konkretizojmë këto me disa shembuj të nxjerrë nga "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954):

E para, "pas një vize vertikale /" në të vërtetë nuk janë vënë vetëm shprehje frazeologjike, siç thuhet në parathënieën e këtij fjalori, në kuptimin linguistik të termit (mjafton të shihet për këtë paragrafi, "pas një vize vertikale /" , i fjalës *mbaj* " / ç'mban nga *Vlora gjer në Berat*, ç'merr nga *Vlora në Berat*; *s'ma mban*, s'guxoj; *mbaj armë*, kam me vete armë, jam i armatosur; *sa e mban këtë plaçkë?*, sa e shet, sa do në të?; *mos më mba diellin*, mos ma ze; *më mbajti 10 lekë*, i ndali nga shuma që duhej të më ipte; *s'të mban kosi*, s'të mban ngopur për shumë kohë". Dhe më poshtë, po "pas një vize vertikale /" janë vënë: "mbahem, 1. kapem të ndonjë send që mos të bie; *mbahu*, se po bie; qëndroj; a *mbahe dot mbi kalë?*; *mbahu*, mos e lësho veten; . . shumë po *mbahet*, mburrem; *me kë mbahe ti?* me ç'anë je; *t'i mbahesh tekstit*, t'i rrih besnik, të shkosh pas tij; . . *s'iu mbaj pa thënë*, s'i u durua" (tj. (f. 296).

Edhe nga vetë shpjegimet e dhëna këtu, që i korespondojnë një fjale të vetme dhe jo një togfjalëshi, merret vesh se në këto raste nuk kemi shprehje frazeologjike, po kuptime të ndryshme të fjalës *mbaj*, të cilat janë bashkëradhitur me shprehje frazeologjike, dmth. janë trajtuar si kuptime frazeologjike.

E dyta, grupimi i përgjithshëm nën shënimin *fig.* ka sjellë përzierjen e kuptimeve të derivuara, të derivuara-figurative dhe frazeologjike (dmth. përgjithësisht të kuptimeve leksikore) me përdorimet e fjalëve metaforikisht, p.sh. tek fjala *kalb* është dhënë pas shënitit *fig.* përdorimi i figurshëm i kësaj fjale në kontekstin e *kalba në dru* (193), tek *lodër* përdorimi i figurshëm i fjalës për *dallavere* (275), tek *lugë* kuptimi frazeologjik në shprehjet *doli lugë e lame*, *rri me lugë në brez* (278), tek *laj* kuptimi frazeologjik në shprehjen *të lan e të lye* dhe përdorimi i figurshëm i fjalës në kontekstin u *lye edhe ky*, u përlye, i vuri njollë vehtes (281), tek *mbath* përdorimi i kësaj fjale në kontekstin *ja mbathu mirë*, ja ngopi, ja hodhi (279), tek *lesh* kuptimi frazeologjik

1) Instituti i Shkencave: "Fjalori i gjuhës shqipe", Tiranë 1954, f. VI.

i shprehjes *lesh e li*, ngatërruar, rrëmuje (265) etj.

Një përzjerje e tillë jo vetëm e vështirëson të kuptuarit e rrugës që ka ndjekur zhvillimi i kuptimitor i një fjale të dhënë, por edhe u jep vlerë të njëjtë leksikologjiko-leksikografike si fakteve gjuhësore, — *kuptimeve* leksikore-frazeologjike të fjalëve, — ashtu edhe fakteve letrare, — *përdorimeve* të figurshme, metaforike të atyre fjalëve.

Dihet se nuk mund të vihen në një plan edhe kuptimet leksikore që përbëjnë strukturën kuptimore të një fjale. Kuptimi qëndror¹⁾ duhet të qëndrojë para kuptimeve të derivuara, por edhe këta shkallëzohen sipas prejardhjes së tyre, sipas shkallës së kristalizimit si elemente gjuhësore dhe sipas mënyrës së lindjes dhe formimit të tyre. Kështu tek fjala *dorë* (f. 91) kuptim qëndror është kuptimi i drejtpërdrejtë, konkret-sendor "pjesa e trupit të njeriut që përbën fundin e krahut dhe shërben për të prekur e për të kapur sendet" (*dorë*₁). Kuptime të tjera të kësaj fjale si *dorë*₂ "dorëz, vesh, vegje: ~ e pallës, ~ e kazanit, ~ e havanit, shtypësi", ose *dorë*₄ "dëftesë" (po aty), sadoqë janë kuptime konkrete-sendore, nuk janë të drejtpërdrejta, por të derivuara nga kuptimi *dorë*₁: prandaj në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) me të drejtë ato nuk janë vënë në një plan me të, janë vënë pas tij, sadoqë të shpërndara.

Këto kuptime, — dmth. kuptimet konkrete-sendore, por jo të drejtpërdrejta, *dorë*₂ e *dorë*₄, — të fjalës *dorë* kanë lindur jashtë lidhjes të *detyrueshme* gjuhësore, në mënyrë pak a shumë të pakondicionuar, relativisht të pavarur nga ambjenti fjalësor, të lirë frazeologjikisht. Kjo do të thotë se këto kuptime të fjalës *dorë*, bile pikërisht për këtë shkak, kapen, vihen re si në shumë lidhje të kësaj fjale me fjalë të tjera, ashtu dhe jashtë çfarëdo lidhjeje.

Padyshim këto kuptime nuk kanë lindur vetvetiu, pa një shkak. Ato kanë lindur në bazë të ligjeve të polisemisë, nëpërmjet lidhjes të ideve ose përmes një krahasimi mbi bazën e kuptimit qëndror *dorë*₁. Këtu mund të kenë vepruar edhe shkaqe linguistike (prania e fjalëve të tjera). Kujtojmë për këtë pohimin e S. I. Ozhegovit²⁾ dhe atë V.V. Vinogradovit³⁾ se s'ka fjalë absolutisht të lirë nga pikëpamja e aftësisë për t'u lidhur me fjalë të tjera. Më të lira janë fjalët me kuptim të drejtpërdrejtë ose gjithashtu, — sipas terminologjisë së V.V. Vinogradovit, — me kuptim nominativ — të prejardhur. Liria e tyre është e kufizuar jo nga ligjet e brendshme të zhvillimit të sistemit semantik të gjuhës, por nga marrëdhëniet sendore-logjike. "Në të vërtetë, — thotë V.V. Vinogradov, — rrethi i përdorimit të kuptimit nominativ të fjalës, rrethi i lidhjes së saj, u përgjigjet lidhjeve dhe marrëdhënieve të vetë sendeve, proceseve e fenomeneve të botës reale . . ." ⁴⁾ B.A. Llarin⁵⁾ përmend katër faktorë që e kufizojnë fjalën në gjuhë: 1. *kuptimet gramatikore të fjalës*

1) Kuptimi qëndror nuk ndikohet nga ambjenti fjalësor, atë e ka fjala jashtë çdo kontakti, prej tij burojë ose atë e kanë në bazë, zakonisht, gjithë kuptimet e tjera të derivuara të asaj fjale. Kuptim qëndror është më shpesh kuptimi primar historik, por këto nuk përputhen gjithënjë, p.sh. *dëgjoj*, tek autorët e vjetër *endiglonj*, nga lat. *intelligere*, ka si kuptim primar historik *kuptoj*, kurse si kuptim qëndror, të sotëm, atë që në lat. shpreh folja *audire*. Siç dihet, në fjalorët filologjikë, me përjashtim të atyre etimologjikë dhe historikë, si kuptim i parë i fjalës shënohet kuptimi qëndror dhe jo ai primar historik.

2) С. И. Ожегов: „О структуре фразеологии“ (lidhur me projektin e fjalorit, frazeologjik të gjuhës ruse) në „Лексикографический сборник“, Akad. e Shk. të BRSS; bot. II rus., Moskë 1957, f. 11.

3) В. В. Виноградов: „Основные типы лексических значений слова“, në „Вопросы языкознания“, 1953, V.

4) V. V. Vinogradov: art. i cit., fq. 12.

5) Б. А. Ларин: „Очерки по фразеологии“ (Mbi sistemin dhe metodën e studimit të materialeve frazeologjike), në „Очерки по лексикологии, фразеологии и стилистике, из-ство Ленингр. Университета, 1956, 207-208.

(p.sh. ndajfoljet lidhen me foljet, mbiemrat me emrat, etj. — J.Th.), 2) *kuptimi real i fjalës* (p.sh. në shqip thuhet *lënd*, *odes* për njeriun dhe *pjell*, *ngordh* për kafshët — J. Th.); 3) *pr rja stilistikore e fjalës* (p.sh. në shqip *fëmijë* dhe *kalama*, *hajde* dhe *ëja* etj. nuk mund të përdoren në të njëjtat raste dhe në çdo stil — J.Th.); 4) *Trajta e përdorimit të fjalës*: "Shumë herë në fjalorë gjejmë fjalë me shënimin "e rrallë", dmth. e dallojmë nga ana e përdorimit të kufizuar. Këto fjalë të rralla s'kanë qenë dikur të tilla, por, për arsye të ndryshme, ngushtohen (në të përdorur — J.Th.) në një etapë të caktuar të zhvillimit të gjuhës nga sinonime më aktive se ato. Prandaj përdorimi i këtyre fjalëve të vjetëruara kufizohet në disa formula tradicionale. Vjetërimi i fjalëve nuk varen as nga kuptimi i tyre themelor, as nga kuptimet gramatikore, as nga koloriti stilistikor. Mbetet vetëm "ligji i traditës", i pakuptueshëm, në shikim të parë" 1). Padyshim, këto kufizime dhe kushtëzime duhen patur parasysh prej çdo leksikografi në analizën e strukturës kuptimore të fjalëve, sepse sa më të theksuara të jenë këto kufizime aq më tepër largohet një kuptim i caktuar i fjalës nga kuptimi qëndror i saj. Këtë gjë mund ta vërejmë, p.sh., tek kuptimet frazeologjike jo vetëm të fjalës *dorë*, por edhe të fjalëve të tjera. Por sidoqoftë, kuptimin konkret-sendor të derivuar fjala e nxjerr sot në një plan paralel me atë primar dhe si të pakondicionuar, p.sh. *dorë*₁ dhe *dorë*₂, *dorë*₄; *këmbë*₁ dhe *këmbë*₂, *këmbë*₄, *këmbë*₅ (f. 210); *qafë*₁ dhe *qafë*₂, *qafë*₃ (f. 442); *sy*₁ dhe *sy*₃, *sy*₄ (f. 512) etj.

Kalimi i fjalës, mbi bazën e kuptimit qëndror, si emërtim për një objekt tjetër, përfordhet aq shumë në procesin e komunikimit, sa që kuptimet e derivuara konkreto-sendore në këtë mënyrë dalin si kuptime qëndrore 1,2,3 . . . Kjo do të thotë që këta kuptime e kanë vendin në fjalor fill pas kuptimit qëndror të fjalës dhe nuk duhet të shpërndahen në vargun e kuptimeve të fjalës poli-semantike e të përzjehshme me kuptimet e derivuara figurative ose frazeologjike.

Prandaj duhet patur parasysh fakti që në shqipet tek fjalët, që si kuptim primar historik kanë një kuptim konkret e në këtë rast ky përfutet me kuptimin e drejtpërdrejtë, qëndror, atëherë kuptim ose kuptime të derivuara jo-figurative do të jenë vetëm ato që shprehin nocione konkrete, si *dorë*₂ e *dorë*₃; *çerdhe* (f. 65) "vend ku fshihen hajdutët, t'arratisurit etj.", ~ *fëmijsh*, institucion edukativ për fëmijë e vegjël, ku këta rrinë e shkojnë ditën, gjersa kthehen nga puna prindët"; *grykë*₂ "qafa e këmishës e thurur me grep: ~ a e këmishës; këmishë me mëngë të gjera, me grykë të mbyllur dhe me një radhë sumbullash të zeza"; *grykë*₃ "goja e një vendi, e një ene, e një sendi: ~ e pusit, e topit, e qypit, e shishes"; *grykë*₄ "gjeog. ngushticë e thellë midis dy maleve"; *grykë*₅ "pjesa e detit që hyn brenda në tokë: ~ e detit"; *grykë*₆ "vendi ku derdhet lumi në det a në liqen"; / ~ a e *gjellës*, pjesa e sipërme e gjellës, krenaja" (f. 148); *këmbëzë*₂ "pjesa e poshtme e një sendi që shërben si mbështetëse, *shm*. ~ a : ~ *karrige*, ~ *trapeze*; ~ *ure*"; *këmbë*₄ "shkul i vogël" etj. Kuptimet e tjera abstrakte ose janë kuptime të derivuara — figurative ose kuptime të derivuara — frazeologjike. P.sh. tek *dorë* si kuptime të derivuara — figurative janë *dorë*₃ "masë²", sa merr një dorë: *një* ~ *miell*, *një* ~ *spinaq*"; *dorë*₅ "cilësi, kualitet: *miell* i ~ *së parë*"; *dorë*₆ "kategorit³ njerëzish: *një* ~ *njerëzish*, *ai asht i dorës sonë*; shtresë shoqërore: ~ e *mesme*; *këso* ~ e, i *këtille*, e *këtille*, në këtë mënyrë" etj.; tek *sy* janë si kuptime të derivuara-figurative. *sy*₂ "vështrim: . . . të *gënjen* ~ *ri*, të *rrejne* ~ *të*, *gënjesh* në matje distancash me *sy*, a në ngjyra", por jo rastet e tjera. Kjo do të thotë që këto kuptime e kanë vendin në fjalor fill pas kuptimit qëndror dhe kuptimeve të derivuara konkreto-sendore të fjalës.

1) *Po aty*, f. 208

2) 3) *Sasi, kategori* në kuptimin abstrakt, si veti të sendeve, fenomeneve etj.

Një kuptim i tillë suplementar lind tek fjalët për shkaqe linguistike të dukëshme, për shkak të ambientit fjalësor, të lidhjes së fjalës me fjalë të tjera. Edhe këtu baza është përsëri një asociacion idesh, ndonjë ngjashmëri sendesh a fenomenesh, e cila bën që të lidhen dy fjalë që shprehin nocione të ndryshme. Por prapsepër lidhja e tyre mbetet e lirë, semantikiisht fjalët nuk shkrihen, nuk krijohet ndonjë kombinim frazeologjik, kuptimi i ri suplementar që lind bën pjesë vetëm në strukturën e një fjale, është i lirë por nuk mund të çfaqet si në lidhje të tjera ashtu dhe jashtë çfarëdo lidhjeje. Struktura kuptimore e fjalëve në shqipet është mjaft e pasur me kuptime të tilla. Për ilustrim po japim disa shembuj nga Çajupi, që në shumicën dërmuese janë elemente të gjuhës së folur popullore: *Po merre fjalënë prapë / dhe shko këtej me vrapë!* (V.1) 54); ljepuri një zë dëgjo / . . . / doli, iku me të katra (M.2) 84); Kujto djalërinë, . . një ëngjëll, një natë / t'iku nëpër duar dhe të la me djalë. (V 66); Dhe kërkonte të më vinte në bukë të qeverisë! (V. 254; përdorim, me sa dimë, çajupjan, i pafornuar mirë si element gjuhësor, me karakter të theksuar letrar); Në shkallë që jam, me far e me fis, ! / me miq, me të njohur, s'di si lipset bërë / të mund t'i kënaq të tërë". (M. 86), Bukuria jote, / lëshërat e tua / posi pëndë korbi, të gjata *mi thua*, (V. 62); fjal'e mirë, fjalë *miku*, / shpëton miknë nga rreziku. (V. 235); zgjodhë majmunë, / q'është m'i zoti nga *fjala*, (M. 126); "Ç'më do? — i tha / me zë të butë — (M. 56); mik me kokë (M. 85); Josifi më prishi nderë / Erdhi natën të më zërë / dhe ra me mua të flerë! (V. 71); Mua Rina më gënjeu, / prishi benë që kish bërë! (V. 96), etj. Ja dhe disa shembuj të tjerë nga vepra "Histori e Shqipërisë" e Naim Frashërit: "se u dog ng'ajo q'e gjeti", "s'e hangri dot me Hynjadhë", "u dha mbi ta si shkëndijë", "kur në derë u dha një djalë" "zjeninë si mizërija", "pashaj me gjuhë të trashë" etj. etj. Në këta shembuj fjalët edhe pse fitojnë kuptime suplementare në lidhje me fjalë të tjera, mbeten prapsepër të lira dhe nuk krijojnë kombinime frazeologjike me to. Prandaj ato e kanë vendin e tyre në fjalor pas kuptimeve të derivuara konkreto-sendore, por para kuptimeve të derivuara — frazeologjike. Para së gjithash, atyre u duhet dhënë një vend më vehte, pa i përzjerë me kuptimin qëndror, kuptimet konkreto-sendore dhe kuptimet frazeologjike të fjalës.

Në përgjithësi, në këtë tip të lindjes së kuptimeve të reja, lidhja e fjalës me një fjalë tjetër është e qartë, shihet ose ndjehet, bile ajo përbën shkakun për lindjen e kuptimit të ri. Por kjo lidhje gjithënjë mbetet një lidhje e lirë fjalësh. Rrjedhimisht, lidhja e fjalës nuk krijon frazeologjizëm, sepse fjalët ruajnë pavarësinë semantike dhe formale, nuk shkrihen në një njësi të vetme. Nga ana tjetër edhe kuptimi i ri që lind është i lirë, jo i lidhur frazeologjikisht. Megjithatë ky kuptim nuk duket kur fjala merret veçmas, pra nuk del në një plan paralel me kuptimin qëndror. Prandaj, për nxjerrjen në dritë të tij është e domosdoshme lidhja e fjalëve me fjalë të tjera, të cilat, zakonisht, janë fjalë për nga kuptimi të ngjashme, p.sh. *dal, iki, shkoj, eci, vrapoj, ja mbath, fugoj* . . . me të katra, etj. Si rrjedhim, këto kuptime nuk mund të pasqyrohen edhe në fjalor, pa pasqyruar ato lidhje të caktuara të fjalës me fjalë të tjera, lidhje në të cilat dalin këto kuptime. Kjo është një shënjë që tregon se këto bashkime të lira janë afër me bashkimet frazeologjike dhe burim për to. Kalimi nga bashkime të tilla në bashkime frazeologjike pengohet vetëm nga mungesa e një shkrirjeje të brendëshme semantike të fjalëve dhe nga shkalla zero e ngurosjes formale e që të dy fjalëve. Por ky kalim është i mundshëm.

1) Çajupi: "vepra", Tiranë, 1957

2) Çajupi: "Mëmëdheu", Tiranë 1958

Nëpërmjet këtij kalimi kanë lindur kuptimet frazeologjike të fjalës *dorë* "pushtet, pronë: *jam në ~ të tij*; *i iku nga ~ a*; *s'ka gjë në ~*, *s'ka rëndësi s'pyetet*; *heq ~*; *e lëshoj ~ e* (*dorë*₇, në "Fjalorin e gjuhës shqipe" janë trajtuar si kuptime të figurshme të fjalës *dorë* dhe nuk janë vënë pas "vizës vertikale /"); *s'bie në ~*, *më ra në ~*; *jep ~*; *s'ja shtrij ~ i kujt*; *i ktheu ~ babës* etj. Këto janë vënë pas "vizës vertikale /".

Këto kuptime, sipas nesh, të derivuara-frazeologjike, të fjalës *dorë* kanë lindur po për shkaqe linguistike, dmth. për shkak të lidhjes së fjalës me fjalë të tjera, veçse jo në lidhje të lirë, por në lidhje të qëndrueshme fjalësh. Kuptimi i ri në këtë rast lind vetëm nëpër kombinime frazeologjike dhe ekziston vetëm ndër to, pra është një kuptim i lidhur frazeologjikisht. Ky kuptim çfaqet vetëm në lidhje të fjalës polisemantike me një fjalë tjetër leksikisht të kufizuar, por semantikisht të pakufizuar. Fjala e dytë është e lirë nga ana kuptimore, hyn në bashkëlidhje me kuptimin e saj primar, të cilin e çfaq në çfarëdo lidhje tjetër fjalësh. Ky raport midis të dy fjalëve (fjalë me kuptim frazeologjikisht të lidhur + fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë), kur ndjehet edhe një farë shkrirje e brendëshme dhe unitet semantik i fjalëve dhe një farë nguroseje formale e lidhjeve sintaksore, i kthen këto bashkime fjalësh në bashkime frazeologjike. Po e ilustruam edhe këtë me disa shembuj nga Çajupi: "bota më nderon / dhe fjala më shkon. (M. 165); Se fjalët i shkuan, / dhe ju afëruan, plot të tjera pula. (M. 163); më shkon fjala / më pret palla". (M. 118); ... shkonin jetënë pa ndarë / dhe dojnë mëmëdhënë. (V. 75); shkonin jetën me puqë në dorë. (M. 13); Trezojnë se një ujë plak / zu një dhel për vjedharak / dhe nukë priti / ndë gjyq e ngriti. (M. 64); Le të bëjë si të dojë, / s'më ha malli për tim birë, (V. 107); shukoni një pellk të gjërë, / me ujë që s'lëvis kurrë, / si kutërbon e mban erë. (V. 243); Një plak fatzi / me dru ngarkuar, / vjosa ndë shtëpi / duke rënkuar. / Këmbët s'i punojnë / se drutë rëdojnë. (M. 55) etj. Formimet frazeologjike të këtilla janë mjaft të pasura në mbarë shqipen.

Por kuptimi i derivuar — frazeologjik lind edhe me anë të transformimit figurativ të një togfjalëshi, me anë të leksikalizimit të një togfjalëshi të lirë, kthimit të tij në një togfjalësh frazeologjik. S.I. Ozhegov¹⁾ lidhur me këtë ve në dukje se këta togfjalësha nga struktura e tyre formale janë të lirë, por marrim domethënë të re figurative ose pësojnë në të folur një përpunim ekspresiv. Kuptimi i ri këtu krijohet jo me ndryshimin e kuptimeve të fjalëve të veçanta që hyjnë në togfjalësh, po me ndryshimin e kuptimit të të gjithë togfjalëshit në tërësi. Në rastin ideal njësitë frazeologjike të tilla kanë homonim në formë togfjalëshin e lirë, i cili shërben si bazë për krijimin e njësisë frazeologjike²⁾.

Shkurt, nuk janë fjalët ato që drejtpërdrejt fitojnë kuptime të reja suplementare, figurative, por kombinimi frazeologjik si njësi tërësore, si të thuash kemi polisemi në frazeologji, "frazeologjizëm polisemantik". Në raport me kuptimin e së tërës pastaj, fjalëve veçan mund t'u jepet ky apo ai kuptim. Ky tip është këndi më i largët i polisemisë së fjalëve, në dallim nga rasti i mëparshëm, ku kemi të bëjmë thjesht me poliseminë e fjalëve. E megjithatë edhe këtu veprojnë po ato ligje të fenomenit të polisemisë së fjalëve mbi marrëdhënien e kuptimit fillestar apo qëndror me atë derivat, mbi rrugën e zhvillimit të kuptimit, mbi bazën sendore-logjike të kuptimit të ri, etj. Veçse këtu njësia që fiton kuptimin suplementar nuk është fjala, po togfjalëshi në tërësi. Këta togfjalësha përgjithësisht janë njësi frazeolo-

1) S. I. Ozhegov: *art. i cit.*, & 17.

2) Shih edhe V. B. Виноградов: „Об основных типах фразеологических единиц в русском языке“, në „А. А. Шаматов - сборник статей и материалов“, А. shk. të B.R.S.S., 1917, 353.

gjike, sepse motivohen, por sapo humbet lidhja e tyre me togfjalëshin e lirë korespondues, ata kalojnë në idioma. Ky kalim ecën sipas një skeme nëpër disa etapa kryesore gjatë zhvillimit historik të togfjalëshave të pazbërthyeshëm nga togfjalëshat e lirë. B. A. Llarin e ndërton kështu këtë skemë: "Së pari, emërtimi i reales, — shprehja e drejtpërdrejtë e perceptimit të ndonjë dukurie të realitetit, — pastaj shprehje figurative që përgjithëson kuptimin, së fundi një simbol konvencional, në të cilin karakteri figurativ ... zbehet ... Sa më tej të shkojë ndryshimi i brendshëm dhe i jashtëm ose rikonstruktimi i shprehjes fillestare, aq më tepër pakësohet karakteri figurativ (figurativiteti), aq më i zbehtë dhe më abstrakt bëhet kuptimi i saj"¹).

Ky tip zhvillimi kuptimor dhe njëkohësisht frazeologjik është gjithashtu i zakonshëm në gjuhën shqipe dhe mjaft i gjerë, p.sh. *i bëj gropën* (dikujt), *ndeua këmbën* (vdiq), *i lava duart* (nga malli), *dal pa lagur*, etj. Kjo pasuri e madhe e këtij tipi në mbarë shqipen, e veçanërisht në gjuhën e folur popullore, është pasqyruar edhe në gjuhën e shkruar, siç na e dëshmon edhe vepra e Çajupit: "kunup'i marrë, / .. ra tek një marimangë, / q'i bëri varrë. (M. 74); "Motrë, dosa na bën varrë, (M. 94, 96); *në këmb'u ngrënë, / për luft'u nisnë, (M. 115); Je i marr'e ke dëshirë / të përziesh me Omirë, / po kaqë lart mos u ngre, / se Omiri nuk ë je. (V. 152); Me gjak me të rreme mbretëron dhe Turku, / pa faj, na ha kokën, se punon si ujku! (V. 91); Këto gjëra janë të larta, të thella; ti s'i kupton dot . . . Unë kam ngrënë jetën time . . . (V. 261); *Hiqni dorë nga rreziku (M. 15); Jo, zot, jo! S'ka vdekur! Po mbase heq shpirt! (V. 255); Këto fjalë tha ky plak, / pastaj mbylli syt'e vdiq. (M. 140); . . . do të mbyl sytë të vdes. (V. 66); Kur më shukon, mos mbyl syn / dhe mos qesh me pleqërinë: (V. 72); ike dhe më le të shkretë! / Bir, o bir! u mbyll shtëpia! (M. 26); Shini Adhamutn' e mjerë / se ç'heq fatziu me grua! / Sos girinë do t'i mbajë, / sos të shara të durojë, (V. 79); Erdhi dita të ngresh kokë, / të kërkosh / Lirinë . . . (M. 17); Pse rrini lidhur me lak? / Pse s'shpëtoni vëndë tuaj? (V. 51); *Nga hunda s'më heq dot kurrë, se nuk jam si çdo burrë (V. 102), etj.***

Si përfundim mund të themi se: 1) në të gjitha rastet kur lind një kuptim i figurshëm, suplementar, i ri, veprojnë ligjet e fenomenit të polisemisë, qoftë tek një fjalë, qoftë tek një togfjalësh; 2) kuptimi i ri mund të lindë: a) për shkaqe jo gjuhësore dhe jashtë çfarëdolloj lidhjeje fjalësh, b) për shkaqe gjuhësore në lidhje të lira fjalësh, c) në lidhje fjalësh kur njera ruan kuptimin e saj primar e megjithatë krijon unitet frazeologjik me tjetrën dhe d) në një kombinim frazeologjik unik, ku nuk fiton ndonjë kuptim të ri secila fjalë, por tërë shprehja si njësi; 3) në dy rastet e para (a, b) kemi polisemi të thjeshtë në fjalë, për dy shkaqe të ndryshme, në rastin e tretë (c) kemi polisemi të brendëshme, kur njera fjalë fiton një kuptim të ri frazeologjikisht të lidhur dhe në rastin e katërt (d) kemi polisemi në frazeologji ose frazeologji polisemantike.

Nga sa u tha më lart del e qartë se kuptimet e derivuara frazeologjike jo vetëm duhen dalluar nga kuptimi qëndror i drejtpërdrejtë, nga kuptimet e derivuara konkreto-sendore dhe nga kuptimet e derivuara-figurative, por edhe ato vetë nuk duhen parë në një plan. Brenda për brenda kuptimeve frazeologjike të një fjale duhen dalluar kuptimet frazeologjike që lindin nga lidhja e fjalës me fjalë të tjera në togfjalësha frazeologjike, nga kuptimet frazeologjike po të kësaj fjale që lindin gjatë transformimit të togfjalëshave të lirë, ku bën pjesë kjo fjalë, në togfjalësha frazeologjike. Po të mbahet parasysh ky dallim, atëherë nuk mund të pranohet si i drejtë parimi që "shprehjet frazeologjike të shpërndahen brenda paragrafit duke u vënë pas kuptimeve,

1) B.A. Llarin art. i cit.; f. 223

me të cilat lidhen "dhe as që duhet të përzjehen tipat e frazeologjizmave (bashkimet, njësitë, idiomat) njeri me tjetrin. Fjala vjen në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) vihet re një përzjerje e dyanëshme: frazeologjizmat futen në paragrafet e kuptimeve qendrore, të derivuara konkreto-sendore apo figurative dhe kuptimet e derivuara jo frazeologjike futen nëpër frazeologjizmat, pas "vizës vertikale / ", p.sh. shprehjet e *dorë*₇ janë frazeologjike ("i iku nga dora, i duel dore, e shtiu në dorë, veç mos më raftë një herë në dorë, s'ka gjë në dorë, vuri dorë, heq dorë, lëshoj dore),— nga ana tjetër "pas vizës vertikale / "janë vënë kuptime jo frazeologjike të fjalës *dorë* ("nën dorë, pa u parë, pa rënë në sy (fig.); *dora e parë, dora e dytë*, vala a radha e parë e dytë në të kryer të një pune; *të marr dorën*(fig.), — në të vërtetë këto kuptime shkojnë me *dorë*₅, *dorë*₆ dhe rasti i fundit me *dorë*₁, sepse këtu është folja *marr* që ka kuptim figurativ, *puth*). Po kështu tek *sy*, jepen shprehjet frazeologjike "m'u errën sytë, më vret sytë; i nguli sytë". Po në këtë paragraf, pas shënimit fig. jepen "ja ka vënë synë; më mbetën sytë më te; i mbylli sytë, vdiq; mbyll një sy, s'u ve re aq fort të metave a një laji"; tek *sy* vihen frazeologjizmat "hidhi një sy gazetës, nuk ma zuri syri; më ra në sy"; tek *sy*₃ futen "më gënjen sy ndër (më) sy; s'kanë sy e faqe; sa për sy e faqe" etj. Nderkaq, pas "vijës vertikale / ", bashkë me frazeologjizmat futen edhe kuptimet e derivuara jo frazeologjike të fjalës *sy*: "mora (bëra) një sy gjumë; syri i heq" etj. Së këtejmi del nevoja që kuptimet frazeologjike të fjalëve të mos përzjehen me kuptimet jo frazeologjike, të vihen pas tyre, në një paragraf të veçantë dhe sipas një rendi të përcaktuar nga mënyra e lindjes dhe shkalla e kristalizimit të tyre.

Por në fjalorët dhe disa gramatika të gjuhës shqipe përzjehen edhe kuptimet e fjalëve, — kuptime tashmë të formuara, qofshin edhe derivate ose derivate-figurative, — me përdorimet e figurshme të fjalëve, gjë që vjen gjithashtu, siç pandehim, nga konceptimi i këtyre kategorive të ndryshme si të një natyre. Po e konkretizojmë këtë me disa shembuj nga "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954). Në këtë fjalor tek fjala *zogë* si kuptim i tretë jepet fig. e re (për një grua) "dhe më poshtë tek *zogëz* (637); tek *pëllumb* si kuptim fig. mbiemror është vënë "i pastër e i bukur" dhe si emër "simbol i paqes e i pavarësisë" (393); tek *sokol* si kuptim fig. "trim me fletë" (499); tek *ujk* si kuptim fig. "i fortë, plot shëndet: je bërë si (sa një) ujk" (589); tek *dhel-për* përfshihet si kuptim edhe "simbol i dredhisë" (99) etj.; kurse nga ana tjetër tek *sorkadhe* nuk jepet përdorimi i kësaj fjale "për një femër të bukur e të shkathët" (500), fjala *sokoleshë* s'pasqyrohet fare; tek *agim* dhe *agon* nuk është dhënë përdorimi për "fillimin e një jete të mirë a të një diçkaje tjetër të bukur" (krh. 3); tek *skifter* nuk është dhënë përdorimi "për trim, i shpejtë, guximtar" (krh. 496) etj. Pra, ajo anë e përmbytjes a e përdorimit që është dhënë tek fjalët *zogë*, *pëllumb*, *sokol* etj. nuk është dhënë tek rastet analoge *sorkadhe*, *agon*, *skifter* etj.

Është e vërtetë se disa herë përdorimet e fjalëve këthehen në një temë semantike, mbi të cilën zhvillohen kuptimet e fjalëve të tjera që formohen nga ato fjalë, si ndodh p.sh. që mbi bazën e përdorimit fig. të fjalës *djall* "njeri i gjallë e i zgjuar me mjaft shejtani . . . fem. — e, *djallushë*" (87) është zhvilluar kuptimi i fjalëve të derivuara prej saj *djallëzi*, *djallëzoi*, *djallëzor*—e, (po aty), *djallëzuar* (i,e), *djalluce*, *djallush* (88); mbi bazën e përdorimit të fjalës *dhel-për* si "simbol i dredhisë" (99) është formuar kuptimi i fjalëve të derivuara *dhel-përi* (99), *dhel-përisht*, *dhelpanak-e* (100); mbi bazën e përdorimit fig. të fjalës *qen* "për të sharë një njeri (në geg. me shum. -a): ~i ~it" është zhvilluar kuptimi i fjalëve të derivuara prej saj *qençe* (445), *qenëri*, *qenërisht*, *qenisht* (446) etj. Por nuk mund të besohet se kjo ka qenë arësyeja që ka përligju, përfshirjen në fjalorët e gjuhës shqipe, duke përfshirë edhe

"Fjalorin e gjuhës shqipe" të 1954, në këto raste, të përdorimeve të fjalëve, meqë në raste të tjera të ngjashme përdorimet e fjalëve nuk janë rreshtuar fare në vargun e kuptimeve të fjalëve, ose janë rreshtuar edhe kur nuk kanë shërbyer si semantemë për zhvillimin e kuptimeve të fjalëve të tjera derivate nga fjalët e para, s.i p.sh. *dru-ja*, "fig. është~", i trashë nga mëndja, shul, hu" (Fjalori i gjuhës shqipe" (1954), f. 95), *paçar* "fig. u bë~, hyn e del kushdo, po bëhet zhurmë e madhe e rrëmujë" (po aty 385) etj., — përdorime që nuk kanë shërbyer si bazë prej nga të zhvilloheshin kuptime, meqenëse nga këto fjalë nuk janë formuar fjalë me semantemë (temë semantike) përdorimet e lartpërmendura,—ose shëmtoj "fig. lë shkretët: na "shëmtoi me ikjen e tij" . . "fig. na u shëmtua shëpia" (po aty, 520), — përdorim i cili nuk shërben si bazë për zhvillimin e kuptimeve të fjalëve shëmtim, shëmtuar (i, e), shëmtuet (i, e) (po aty); shërbëtor "fig. ai që është në shërbim të një tjetri dhe punon n'interes të tij" (521, fjala këtu sigurisht është përdorur në kuptim të keq), — përdorim i cili nuk reflektohet në fjalët e tjera të së njëjtës çerdhe, si tek shërbim, shërbesë, kurse tek shërbej është dhënë si element i kuptimit të fjalës: " i bëj shërbim, i sjell dobi, i hyj në punë", pa ndonjë ngarëse emocionale, duke i koresponduar përafërsisht shërbim, etj.

Pandehim se shkak i vërtetë që krijon këtë gjendje në fjalorët e shqipes përgjithësisht është të kuptuarit jo saktë i koncepteve mbi kuptimin leksikor si element gjuhësor dhe përdorimin e figurshëm të fjalës si element letrar, moskuptimi i marrëdhënieve dhe ndryshimeve nëmes tyre si edhe moszbatimi gjer në fund i një kriteri të vetëm për pasqyrimin e tyre në fjalor..

Një gjendje e tillë pasqyrohet, siç u tha, edhe në ndonjë gramatikë tonën. Mjafton të përmendim "Sintaksën" 1) e K. Cipos, në të cilën metafora letrare nuk dallohet nga metafora gjuhësore. Do shënuar se këtu ka edhe një ngatërrim termash kuptim dhe përdorim i fjalës, gjë që vjen, siç kujtojmë, nga vetë mosdallimi i këtyre termave nga shumë autorë në gjuhësinë shqiptare përgjithësisht. Kështu në këtë "Sintaksë" thuhet se "në rasën e parë . . fjala gomar është përdorur me kuptim të mirfilltë (kafshë shtëpijake — J. Th.), kurse në rasën e dytë me kuptim të fytyruar (sharje për një njeri që nuk di të shkruaj e të këndoje fare)" 2). Është e qartë se as në rasën e parë nuk kemi përdorim, po aq sa as në rasën e dytë nuk kemi kuptim, qoftë edhe "të fytyruar" — në kuptimin gjuhësor të këtyre termave. Po kështu renditen krahas kuptimeve të drejtpërdrejta dhe përdorimet letrare të fjalëve maskë "ata punonin me maskën e patriotizmit të ngjitur e të puthisur mirë pas faqes"; krah" atë e kam pasur krah, . . dmth ndihmë"; burim "burimet e historisë, burimet e pasurisë etj."; "Fjala bukë veç kuptimit që dimë ka në folklorin tonë edhe kuptimin e nëpunësisë"; "herë herë vishen edhe me kuptim ironik. Kështu p.sh. atij që është i shkathtë i thonë: fluturidhe; kush është i gjatë po i ligët, është një tërkuz i zhdredhur; një që është i trashë nga mëndja është një shëlk ose një krap, ose një gallof, një hardall etj., një që punon nënë dhe është një urith, një thëngjill i mbuluar" 3). Këtu nga "Sintaksa" e K. Cipos përmendim ata shembuj, në të cilët në të vërtetë metafora letrare "nuk është pjekur" si metaforë gjuhësore dhe të flasësh këtu për kuptim të këtyre fjalëve është tepër shpejt. Duke i parë këto fjalë në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) vërehet se tek gomar është përfshirë përdorimi si "simbol i trashëmanësisë dhe i durimit" (143); tek maskë pas shënimit fig. radhitet njësia frazeologjike "i hoqi maskën, i tregoi fytyrën e vërtetë" (193); tek krahë vihet kuptimi frazeologjik "kam krah, kam përkrasje" (235); tek burim pas shënimit fig. vihet" origjina, gurra; lajme nga burime

1) K.Cipo: Sintaksa, Tiranë 1952, ft.118-119

2) Po aty.

3) Po aty.

të sigurta; burimet historike, dokumente, tekste të kohës, që shërbejnë si material për historinë" (52); tek *krap*, pas shënimit *fig.* është dhënë përdorimi i kësaj fjale "për një njeri të trashë nga mendja" (236); tek *gallof* "fig. budalla, guhak" (135); tek *thëngjill* "fig. thëngjill i mbuluar, hipokrit, jo i sinqertë" (584), kurse tek *tërkuzë* (564), *shelg* (517), *urith* (592), *fluturidhe* (nuk gjindet në Fjalor) përdorimi metaforik i këtyre fjalëve nuk është pasqyruar. Në këtë mënyrë problemi jo vetëm nuk merr ndonjë zgjidhje më të mirë, por përkundrazi ndërlikohet edhe më tepër meqenëse përdorimet metaforike përzehen edhe me *kuptimet* e derivuara e ato frazeologjike.

Për t'i u shmangur këtij ndërlikimi duhet mbajtur një kriter i përcaktuar mirë për të dalluar përdorimin e figurshëm, metaforik të fjalëve nga kuptimet e tyre të drejtpërdrejta, të derivuara ose frazeologjike. Është rasti këtu të sjellim fjalët e akad. V. V. Vinogradov lidhur me këtë çështje. "Përdorimi është ose gjurmë e aplikimeve të mëparshme të fjalës, që s'kanë krijuar kuptim të veçantë, ose një aplikim i ri i njerit nga kuptimet e fjalës në një ambjent frazeologjik individual, jo plotësisht të zakonshëm, në një situatë origjinale, me tendencë të re figurative. Gjatë aplikimit figurativ ose të ndërlikuar kompozicionalisht të fjalës me ndonjë nga kuptimet e saj themelore linden nuanca kuptimore të reja, origjinale. Megjithë këto nuanca semantike nuk formojnë një kuptim më vete. Ato janë të përkohëshme, të paqëndrueshme, nga një herë bile kapen me vështirësi. Ato s'janë veti për gjuhën e përbashkët, sadoqë janë të kuptueshme për të gjithë"¹⁾

Zgjidhja e këtij problemi siç dihet shpreh njëkohësisht marrëdhëniet dhe kufirin nëmes stilistikës gjuhësore me atë letrare. Kjo e fundit, me metaforën letrare, dmth. me përdorimet e figurshme, metaforike të fjalëve, përbën një teren të gjërë e produktiv prej nga mbijnë e piqen *kuptimet* e reja leksikore të fjalëve polisemantike.

Por që përdorimet metaforike të fjalëve të shënuara më sipër të kristalizohen si elemente gjuhësore, si *kuptime* të fjalëve, duhen disa kushte, të cilat shërbejnë edhe për t'i dalluar ato njerin nga tjetri.

Së pari, përdorimi metaforik i fjalës *dhelprë* shërben si semantemë për *kuptimin* e ri që lind tek fjala *dhelprë* ose *dhelprë*, por ai, si të thuash, "shkrihet", humbet si i tillë, dmth. si metaforë letrare, humb karakterin e theksuar figurativ dhe ngarkesën emocionale dhe transformohet nga një sinjalizim i tërthortë në një element emërtonjës i drejtpërdrejtë. Kështu kanë lindur, fjala vjen, edhe kuptimet 2,3,4,5,6 të fjalës *grykë* (Shih "Fjalori i gjuhës shqipe" 1954, f. 148). Kështu kanë lindur nga figurat letrare, por tashmë e kanë humbur karakterin e figurshëm-emocional dhe janë kthyer në fakte gjuhësore, kuptimet e fjalës "i lirë: jo i zënë, bosh (ky vend është i lirë); pa pagesë, pa ftesë (hyrje e lirë); pa rimë e me masa të ndryshme (vargje të lira); që s'i mbahet fjalë për fjalë origjinalit (përkthim i lirë)" etj. (po aty, 273), ose kuptimi 2 "del: len dielli" i fjalës *lej* (po aty, 263), kuptimi 2" një lloj drapëri në trajtë të sqepit të lejlekut" i fjalës *lejek* (po aty, 263), kuptimi "institucion edukativ për fëmijët e vegjël, ku rrinë e shkojnë ditën, gjersa kthehen nga puna prindët" i fjalës *çerdhe* (po aty, 65), kuptimet 2,4 të fjalës *flutë* (po aty 123), kuptimi 2 i fjalës *gjuhë*²⁾ etj. Shembuj për këtë ka mjaft.

Kur përdorim fjalën *pazar* për një "vend me rrëmuje e zhurmë të madhe", *uik* për "një njeri grykës a të keq", *dhelprë* për "një njeri dinak", *pëllumb* për "një njeri të bukur, të pastër" etj., ne vetëm kemi çvendosur emërtimin e diçkaje për diçka tjetër, kemi ndërtuar një metaforë, e cila shpreh edhe ndje-

1) В. В. Виноградов: „Основные типы лексических значений слова“, në „Вопросы языкознания“, 1953, f. 22.

2) К. Сипо e përfshin këtë në kategorinë e metaforës letrare *verp.* e cituar, 119.

njën, qëndrimin tonë kundrejt objektit të dytë, kemi sinjalizuar në mënyrë të tërthortë, me anë të një objekti tjetër, një objekt, i cili e ka emërtimin e vet të drejtpërdrejtë. Pra, edhe *përdorimi* metaforik i fjalës ka vlerë komunikative, por jo funksion të drejtpërdrejtë emërtonjës¹⁾.

Ndërkaq, tek kuptimet e sipërpërmendura të fjalës *grykë* etj., metafora letrare nuk ndihet më, karakteri i figurshëm është rronitur, ngarkesë emocionale nuk ka, emërtimi është i drejtpërdrejtë. Pra, gjatë procesit të transformimit të *përdorimit* të figurshëm të një fjale në një *kuptim* leksikor të formuar të kësaj fjale, jo vetëm tretet karakteri metaforik i përdorimit dhe ngarkesa emocionale, por kemi edhe kalimin nga një sinjalizim anësor, i tërthortë, "me një ndërmjetës", në një emërtim të drejtpërdrejtë. Nëpër këto linja ka ecur edhe formimi i fjalëve të reja me semantemë përdorimin metaforik të një fjale, si tek shembujt e përmendur më sipër *djallëzi*, *djallëzoj*, *djallëzor*, *djallëzuar* (i, e), *djallucë*, *djallushe* ("Fjalori i gjuhës shqipe" 1954, f. 88); *dhelperi*, *dhelperisht*, *dhelpanak*₁ (po aty, 100), ose *lindje*₂ e *lindje*₃ (po aty 273) etj.

Do kujtuar se ngarkesa emocionale, si një element i kuptimit leksikor, mund të përfshihet në përbajtjen e një fjale (krh. *fytyrë* (po aty 134) / *surrat* (511), *mësues*(311) / *dhaskal*(99), *burrë* / *burrec* (52) etj.²⁾, por ne flasim për humbje të ngarkesës emocionale dhe të metaforës letrare përgjithësisht në ato raste kur kemi një kalim nga një fakt letrar në një fakt gjuhësor, dmth. nga një *përdorim* metaforik në një *kuptim* leksikor të formuar.

Do thënë gjithashtu se një kufi të prerë njëherë e përgjithënjë nëmes *përdorimit* letrar dhe *kuptimit* leksikor të fjalës, kur i dyti buron nga i pari nuk mund të ketë. Ka raste të ndërmjetme, kalimtare, siç janë fjalët *dreq*, *i paudhë*, *shejtan*, *largnesh*, *engjëll* etj., kur përdoren për njerëz me cilësi a veti të caktuara, më tepër fizike e të karakterit.³⁾

Së dyti, përdorimi metaforik, letrar i fjalës është një fakt me një shtrirje të kufizuar, që njihet dhe përdoret nga njerëz të veçuar, në vepra të veçuara ose të shumtën në stile të veçanta. Kjo karakteristikë lidhet me një anë tjetër të metaforës letrare: me karakterin e saj subjektiv, si produkt individual, me të cilin individi ose një grup i kufizuar individësh shprehin mënyrën e tyre të sinjalizimit, të komunikimit, ashtu siç e kuptojnë ata botën në mënyrë të përfytyruar.

Nga ana tjetër, këto që u thanë spjegojnë edhe përse përdorimet metaforike të fjalëve nuk janë fakte të detyrueshme gjuhësore për gjithë shoqërinë. Kështu, p.sh. nuk është e detyrueshme që të gjithë njerëzit ta quajnë grykësin *ujk*; dinakun *dhelper*, apo budallain *krap*. Jo të gjitha nënat domosdo duhet t'i thërrasin fëmijët e tyre *pëllumb* apo *drenushë*. Mund t'i thërrasin edhe *sokol*, *petrit*, *thëllënzë* etj.

Kjo ndodh nga që, siç u tha më lart, këto fjalë vetëm janë përdorur në mënyrë të re, për të sinjalizuar me rrugë të tërthortë (me anën e një fjale që emërton një nocion të caktuar) një objekt tjetër, — i cili e ka emërtimin e vet të drejtpërdrejtë, — mbi bazën e një ane të ngjashme midis tyre. Pa dyshim edhe përdorimet e fjalëve nuk kanë të njëjtën shtrirje. Nga kjo pikë

1) Shih edhe tek Louis Hjelmlev: "Dans quelle mesure les significations des mots peuvent-elles être considérées comme formant une structure" („Можно ли считать, что значения слов образуют структуру?", në „Новое в лингвистике", 1962, 125.

2) Shih për këtë Stephen Ullman: "Descriptive semantics and linguistic typology" („Дескриптивная семантика и лингвистическая типология" në „Новое в лингвистике", 1962, II, 29.

3) Për këtë jemi shprehur në tekstin tonë "Leksikologjia shqipe", bot. i Universitetit Shtet. të Tiranës, 1961, 8.

pamje dallohet metafora e përgjithëshme popullore nga ajo individuale e okazionale. Por që të dyja këto dallohen nga kufizimi në shtrirje karshi kuptimit.

Kuptimi leksikor i fjalës, përkundrazë, qoftë edhe i dalë mbi bazën e përdorimit metaforik të kësaj fjale, është një fakt i përgjithshëm dhe i detyrueshëm për shoqërinë, sepse ky kuptim është aftësi absolute, veçori e fjalës për të emërtuar drejtpërdrejt një nocion të caktuar. Kështu, p.sh. për të gjithë është e detyrueshme që të përdorim për emërtimet e nocioneve përkatëse fjalët *çerdhe* (fëmijësh), *kopësht* (fëmijësh), *grykë* (pusi), *qafë* (mal), *këmbë* (karrigeje) etj.

Shtojmë se, ndërsa në rastin e parë (të kalimit nga një emërtim i tërthortë në një emërtim të drejtpërdrejtë) kemi një kalim nga një cilësi në një cilësi tjetër, një ndryshim cilësor, në rastin e dytë (të zgjerimit të rrethit të përdorimit) kemi ndryshime sasimore që përgatisin dhe realizojnë atë ndryshim cilësor. Mirëpo, siç shprehet akad. V. V. Vinogradov, "analiza e ndryshimeve cilësore në strukturën e kuptimeve të fjalëve, — në rrjedhjen e tyre historike, — është një nga detyrat themelore të leksikologjisë. Përcaktimi ose spjegimi i kuptimit të fjalëve është një qëllim kryesor i hartimit të fjalorit, objekt i drejtpërdrejtë i leksikografisë"¹). Nga gjithë sa u tha më sipër rrjedhin këto përfundime:

I. *Kuptimi* i ri i fjalës, si fakt gjuhësor i formuar, i përgjithshëm dhe i detyrueshëm, domosdo duhet pasqyruar në fjalor brenda strukturës kuptimore të fjalës, sipas rendit të vet, kurse *përdorimi* i ri i fjalës, si fakt i stilistikës letrare, jo i përgjithshëm dhe jo i detyrueshëm, nuk duhet përfshirë domosdo në strukturën kuptimore të fjalës titull;

II. *Përdorimi* i ri i fjalës, si bazë për lindjen e një *kuptimi* të ri, megjithatë, duhet dhënë në fjalor, edhe pse jashtë strukturës kuptimore të fjalës titull, mbase pas një shënje të veçantë, domosdo sidomos në rastet kur ky *përdorim* ka qenë pikënisje për zhvillimin e kuptimeve të fjalëve të tjera të prejardhura, si tek tipi *dhelperi*, -sht etj.

Përsa i përket masës, — sepse përfshirja e të gjitha *përdorimeve* letrare të fjalëve do të ishte teorikisht e papërligjeshme dhe praktikisht e pamundur, — kjo mbetet gjithënjë e papërcaktuar mirë, meqenëse vlerësimi subjektiv i fakteve këtu gjithënjë do të mbetet dhe, nga ana tjetër, meqenëse ndryshimet sasimore në *përdorimin* e fjalëve dhe ndryshimet cilësore të tij në *kuptim* leksikor mbeten procese të vazhdueshme në gjuhë.

Së fundi, shënojmë se *përdorimi* letrar i fjalës, si një sinjalizim i tërthortë, e ka më të vështirë të na sjellë ndër mend nocionin përkatës, sidomos kur fjala përdoret shkëputur, pa shtjellime dhe pa kontekste. Që këtë rrjedh detyra e fjalorëve që edhe *përdorimet* e fjalëve të spjegohen sa më qartë e plotë dhe të vihen kontekstet që përmbajnë këto përdorime, — detyrë që në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) nuk është zgjidhur në mënyrë të kënaqëshme. Nëqoftëse për një *kuptim* të një fjale mund të jepet si spjegim vetëm një fjalë sinonime dhe mund të mos ilustruhet me shembuj, — meqenëse fjala në një kuptim hyn në shumë kontekste, — kjo nuk do të mjaftonte për *përdorimin* e kësaj fjale, i cili kërkon patjetër kontekstin, atë kontekst që tregon pikërisht se si përdoret kjo fjalë në një mënyrë të re.

Me gjithë këto që u thanë, problemi i pasqyrimin të kuptimeve e përdorimeve të fjalëve në fjalorë të gjuhës shqipe mbetet një problem që do studiuar gjërësisht e thellë. Zgjidhja e këtij problemi është një faktor që do të lejojë hartimin e një fjalori më të mirë në të ardhmen.

1) В. В. Виноградов: „Основные типы лексических значений слова“, në „Вопросы языкознания“, 1953, f. 3.